2	101-200	4	0.70%
3	201-300	18	3.13%
4	301-400	40	6.96%
5	401-500	26	4.52%
6	501-600	55	9.57%
7	601-700	44	7.65%
8	701-800	77	13.39%
9	801-900	86	14.96%
10	901-1000	67	11.65%
11	1001-1100	55	9.57%
12	1101-1200	42	7.30%
13	1201-1300	21	3.65%
14	1301-1400	18	3.13%
15	1401-1500	7	1.22%
16	1501-1600	5	0.87%
17	1601-1700	7	1.22%
18	1701-1800	0	0.00%
19	1801-1900	0	0.00%
20	1901- 2000	0	0.00%
21	2001 - 2100	1	0.17%
Totali		575	100%

Grafiku 16



Koha më e gjatë e shqyrtimit gjyqësor të një rekursi administrativ në GJL për çështjet e vendimuar në vitin 2016 rezulton të jetë 2080 ditë. Rekursi për këtë çështje është regjistruar në dt. 04.04.2011 dhe nga regjistri rezulton të jetë vendimuar në datë 13.12.2016 (nr. *Vendimi 3093*).

Ndërkohë, në tabelën 17 jepet një renditje e 30 rekurseve të vendimuara në vitin 2016 që reflektojnë vonesat më të mëdha deri në marrjen e vendimit.

Tabela 17


Nr	Nr. Regjistri	Nr. vendimi	Nr Akti	Data e rregjistrimit	Data e vendimit	Kohëzgjatje Shqyrtimi në ditë	Vonesa tej afatit 90 ditor
1	574	3093	765	04-Pri-11	13-Dhj-16	2080	1990
2	575	3094	1092	23-Pri-12	14-Dhj-16	1696	1606
3	573	3071	1290	11-Maj-12	13-Dhj-16	1677	1587
4	305	2625	2509	21-Tet-11	17-Maj-16	1670	1580
5	572	3095	1475	25-Maj-12	13-Dhj-16	1663	1573
6	129	2051	2101	16-Sht-11	01-Mar-16	1628	1538
7	85	2072	1882	01-Sht-11	09-Shk-16	1622	1532
8	124	541	2186	22-Sht-11	01-Mar-16	1622	1532
9	489	3226	2045	11-Krr-12	04-Tet-16	1546	1456
10	461	2447	1951	02-Krr-12	13-Sht-16	1534	1444
11	295	2744	642	06-Mar-12	11-Maj-16	1527	1437
12	242	491	658	06-Mar-12	24-Shk-16	1450	1414
13	447	1483	675	07-Mar-12	19-Pri-16	1504	1412
14	446	2741	2289	03-Gsh-12	13-Sht-16	1502	1379
15	127	2742	2368	05-Sht-12	13-Sht-16	1469	1367
16	105	536	637	05-Mar-12	01-Mar-16	1457	1430
17	244	1974	1453	23-Maj-12	19-Pri-16	1427	1337
18	215	1070	1344	15-Maj-12	05-Pri-16	1421	1331
19	583	3207	240	29-Jan-13	20-Dhj-16	1421	1331
20	433	2178	2309	30-Gsh-12	12-Krr-16	1412	1322
21	103	474	1189	04-Maj-12	23-Shk-16	1390	1300
22	586	3209	658	06-Mar-13	20-Dhj-16	1385	1295
23	593	3201	715	11-Mar-13	20-Dhj-16	1380	1290
24	164	675	1627	05-Qer-12	15-Mar-16	1379	1289
25	432	2179	2568	04-Tet-12	12-Krr-16	1377	1287
26	165	676	1778	18-Qer-12	15-Mar-16	1366	1276
27	187	1007	2034	10-Krr-12	29-Mar-16	1358	1268
28	585	536	988	08-Pri-13	20-Dhj-16	1352	1262
29	431	2180	2958	07-Nën-12	12-Krr-16	1343	1253
30	516	3229	525	28-Shk-13	01-Nën-16	1342	1252

Afati i dorëzimit të vendimeve, Kolegji Administrativ, viti 2016

Nga vlerësimi për vitin 2016, rezulton se brenda afatit ligjor prej 10 ditësh janë dorëzuar në sekretarinë e Gjykatës së Lartë vetëm 82 nga 595 vendime të analizuara, ose **14%** e totalit. Pjesa tjetër prej 513 vendimesh ose **86%** e totalit dalin jashtë këtij afati. Kjo do të thotë se për vitin 2016, dispozitat e nenit Neni 64, pika 3 e ligjit 49/2012, të ndryshuar kanë gjetur zbatim në masën **14%** në Kolegjin Adminsitrativ të Gjykatës së Lartë.

Tabela & Grafiku 18

Nr	Fasha kohore	Numri i vendimeve
1	0 - 10 dite	82
2	mbi 10 dite	513
	Totali	595



Ndërkohë, rezulton se 61.5% e totalit të vendimeve të analizuara janë dorëzuar në sekretarinë e Gjykatës brenda 30 ditëve nga seanca përfundimtare. Ligji organik i Gjykatës së Lartë (në fuqi në kohën që analizon ky vlerësim tematik) referon pikërisht këtë afat për dorëzimin e vendimeve të arsyetuara në sekretarinë e Gjykatës. Është e qartë në këtë pikë se dy ligje të ndryshme, për më tepër me të njëjtën hierarki normative, caktojnë afate të ndryshme përsa i takon të njëtin veprim procedural.

Kohëzgjatja mesatare e dorëzimit në sekretarinë e Gjykatës së Lartë të një dosje gjyqësore administrative të vendimuar gjatë 2016-ës rezulton të jetë **31.6 ditë**. Kjo shifër e tejkalon 3 herë afatin që parashikon ligji 49/2012, i ndryshuar për dorëzimin e dosjes për çështjeve administrative në shkallën e tretë të gjykimit dhe pothuajse është në ekuilibër me afatin 30-ditor që përcaktonte neni 19 i ligjit Nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të RSH” (tashmë i shfuqizuar).

Koha më e gjatë e dorëzimit të një vendimi të arsyetuar në vitin 2016 nga Kolegji Administrativ i GJL rezulton të jetë 172 ditë. Vendimi për këtë rekurs mban datën. 31.03.2016, ndërkohë që është dorëzuar në sekretari në date 19.09.2016 (nr. Vendimi 2686).

Në tabelën 19 më poshtë jepet një renditje e 30 çështjeve të vendimuara në vitin 2016 që reflektojnë edhe vonesat më të mëdha në dorëzimin e dosjes gjyqësore nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

Tabela 19

NR.	Nr. Regjistri	Nr Vendimi	Nr. Akti	Data e Vendimit	Data e Dorezimit	Kohezgjatja ne Dorezim	Kohezgjatja tej afatit 10 ditor
1	211	2686	797	31-Mar-16	19-Sht-16	172	162
2	76	2992	429	04-Shk-16	19-Krr-16	166	156
3	385	3189	3816	28-Qer-16	30-Nën-16	155	145
4	437	3089	1305	13-Krr-16	24-Nën-16	134	124
5	290	2684	1855	11-Maj-16	21-Sht-16	133	123
6	294	2693	1914	11-Maj-16	21-Sht-16	133	123
7	435	3072	1185	13-Krr-16	23-Nën-16	133	123
8	293	2694	1930	11-Maj-16	19-Sht-16	131	121
9	10	223	2918	19-Jan-16	26-Maj-16	128	118
10	423	3144	1892	06-Krr-16	11-Nën-16	128	118
11	68	1969	4664	28-Jan-16	02-Qer-16	126	116
12	188	1005	3338	29-Mar-16	21-Krr-16	114	104
13	436	3143	1761	13-Krr-16	03-Nën-16	113	103
14	191	1000	1097	29-Mar-16	13-Krr-16	106	96
15	234		3162	12-Pri-16	26-Krr-16	105	95
16	516		525	01-Nën-16	07-Shk-17	98	88
17	243	1481	2817	19-Pri-16	20-Krr-16	92	82
18	242	1483	675	19-Pri-16	19-Krr-16	91	81
19	523		953	15-Nën-16	14-Shk-17	91	81
20	249	1482	2296	21-Pri-16	20-Krr-16	90	80
21	543		2330	22-Nën-16	20-Shk-17	90	80
22	410	2701	1196	30-Qer-16	27-Sht-16	89	79
23	409	2685	2001	30-Qer-16	26-Sht-16	88	78
24	524		3373	15-Nën-16	10-Shk-17	87	77
25	268	1421	1540	26-Pri-16	21-Krr-16	86	76
26	53	1885	2307	28-Jan-16	19-Pri-16	82	72
27	95	1467	604	11-Shk-16	03-Maj-16	82	72
28	96	1462	610	11-Shk-16	03-Maj-16	82	72
29	97	1458	611	11-Shk-16	03-Maj-16	82	72
30	86	468	1408	09-Shk-16	28-Pri-16	79	69

GJETJET E VLERËSIMIT TEMATIK VITI 2015

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË


Kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor, Kolegji Administrativ, viti 2015

Gjatë vitit 2015, Kolegji Administrativ i GJL dha 710 vendime gjyqësore. Në analizë nga INFOCIP u morën 709 vendime (të dhënat e një vendimi ishin të palexueshme). Nga vlerësimi rezultoi se vetëm 4 nga 709 çështjet e vendimuara në 2015-ën janë shqyrtuar **brenda afatit ligjor 90-ditor**, sikurse parashikon ligji 49/2012, *i ndryshuar*.

Çështjet e shqyrtuara brenda afatit në vitin 2015 përfaqësojnë vetëm 0.5% të totalit. Kjo e dhënë përfaqëson njëkohësisht edhe nivelin e zbatimit të nenit 60, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, *të ndryshuar* nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë për çështjet e vendimuara në 2015-ën. Në kuadër të metodologjisë së këtij vlerësimi, zbatueshmëria nën 1% e dispozitës ligjore në fuqi konsiderohet *nivel shumë i ulët i zbatimit të ligjit*.

Tabela & Grafiku 20

Nr	Fasha kohore	Numri i vendimeve
1	0 – 90 dite	4
2	mbi 90 dite	705
	Totali	709



Për rekursitet të cilat morën vendim nga Kolegji Administrativ në 2015, **koha mesatare e pritjes ishte 968 ditë nga koha e regjistrimit**. Kjo e dhënë e tejkalon mbi 10 herë afatin që parashikon ligji 49/2012, *i ndryshuar* për shqyrtimin gjyqësor administrative në shkallën e tretë.


Koha më e gjatë e shqyrtimit gjyqësor të një rekursi administrativ në GJL për çështjet e vendimuara në vitin 2015 rezultoi të jetë 1889 ditë. Rekursi për këtë çështje është regjistruar në datë 03.09.20110 dhe mori vendim në datë 05.11.2015 (nr. Vendimi 4248).

Shumica e çështjeve të vendimuara në vitin 2015 janë të grupuara në fashat kohore midis 1200 dhe 1300 ditësh (13% e totalit). Tabela dhe grafiku 21 (më poshtë) ofrojnë një vizualizim të shpërndarjes së kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor sipas fashave kohore 100-ditore gjatë vitit 2015.

Tabela 21

Periudha Janar - Dhjetor 2015			
Nr.	Fasha Kohore në Ditë	Nr vendimesh gjithsej	Shprehur në %
1	0-100	4	0,58%
2	101-200	11	1,61%
3	201-300	11	1,61%
4	301-400	8	1,17%
5	401-500	15	2,19%
6	501-600	41	5,99%
7	601-700	37	5,40%
8	701-800	62	9,05%
9	801-900	80	11,68%
10	901-1000	82	11,97%
11	1001-1100	78	11,39%
12	1101-1200	73	10,66%
13	1201-1300	92	13,43%
14	1301-1400	54	7,88%
15	1401-1500	26	3,80%
16	1501-1600	6	0,88%
17	1601-1700	1	0,15%
18	1701-1800	1	0,15%
19	1801-1900	3	0,44%
Totali		685	100%

Grafiku 21



Në tabelën 22 jepet një renditje e 30 çështjeve të vendimuara në vitin 2015 që reflektojnë edhe vonesat më të mëdha ndër të gjitha vendimet e marra në 2015-ën, të analizuara në kuadër të këtij monitorimi.

Tabela 22

Nr	Nr Vendimi	Nr. Akti	Date Regjistrimi	Date Vendimi	Kohezgjatja në Shqyrtim
1	4248	1852	03-Sht-10	05-Nën-15	1889
2	4579	2604	11-Nën-10	10-Nën-15	1825
3	1743	557	15-Mar-10	10-Mar-15	1821
4	2917	888	28-Pri-10	10-Mar-15	1777
5	3401	871	15-Pri-11	13-Tet-15	1642
6	2960	1029	02-Maj-11	15-Sht-15	1597
7	1305	2867	20-Dhj-10	17-Mar-15	1548
8	1137	141	26-Jan-11	17-Pri-15	1542
9	1316	269	09-Shk-11	14-Pri-15	1525
10	1580	299	11-Shk-11	26-Mar-15	1504
11	3570	988	28-Pri-11	09-Qer-15	1503
12	1650	764	04-Pri-11	05-Maj-15	1492
13	3177	1031	02-Maj-11	02-Qer-15	1492
14	1315	669	28-Mar-11	19-Pri-15	1483
15	1605	919	21-Pri-11	12-Maj-15	1482
16	1155	46	14-Jan-11	03-Shk-15	1481
17	1157	192	28-Jan-11	17-Shk-15	1481
18	3066	859	15-Pri-11	05-Maj-15	1481
19	1992	1218	17-Maj-11	02-Qer-15	1477
20	1251	1387	30-Maj-11	09-Qer-15	1471
21	2863	970	27-Pri-11	05-Maj-15	1469
22	1606	1081	05-Maj-11	12-Maj-15	1468
23	1616	1137	11-Maj-11	05-Maj-15	1455
24	1720	627	18-Mar-11	10-Mar-15	1453
25	1152	131	25-Jan-11	13-Jan-15	1449
26	1151	154	26-Jan-11	13-Jan-15	1448
27	2961	2264	29-Sht-11	15-Sht-15	1447
28	85	201	31-Jan-11	15-Jan-15	1445
29	1397	216	02-Shk-11	15-Jan-15	1443
30	1153	259	08-Shk-11	20-Jan-15	1442


Afati i dorëzimit të vendimeve, Kolegji Administrativ, viti 2015

Nga vlerësimi rezulton se, brenda afatit ligjor prej 10 ditësh janë dorëzuar në sekretarinë e Gjykatës së Lartë **9%** e totalit, ose 65 nga 709 vendimesh të analizuar. Pjesa tjetër prej 644 vendimesh ose **91%** e totalit dalin jashtë këtij afati (*periudha e analizuar Janar-Dhjetor 2015*).

Kjo do të thotë se, për vitin 2015, dispozitat e nenit 64, pika 3⁷ e ligjit 49/2012, të ndryshuar kanë gjetur zbatim në masën **9%** në veprimtarinë gjyqësore Kolegjit Adminsitrativ të Gjykatës së Lartë (shih grafikun 9).

Tabela 14, Grafiku 9

NR.	Fasha Kohore	Numri i vendimeve
1	0 - 10 dite	65
2	mbi 10 dite	644
	Totali	709



Kohëzgjatja mesatare e dorëzimit në sekretarinë e GJL të një dosje gjyqësore të vendimuar gjatë 2015-ës **rezulton të jetë 41.6 ditë**. Kjo shifër e tejkalon 4 herë afatin që parashikon ligji 49/2012, i ndryshuar për dorëzimin e dosjes për çështje administrative në shkallën e tretë të gjykimit. Nëse kjo e dhënë do të kontrastohej me parashikimet që përmbante neni 19 i ligjit 8588, datë 15.3.2000, tashmë i shfuqizuar, atëherë afati ligjor i përshkruar në ligj do të rezultonte i kaluar me vetëm 11.8 ditë.

Koha më e gjatë e dorëzimit të një dosje në sekretarinë e GJL për çështjet e vendimuar në vitin 2017 nga Kolegji Administrativ i GJL rezulton të jetë 309 ditë. Rekursi për këtë çështje është vendimuar në dt. 15.09.2015 dhe është dorëzuar në sekretari në datë 20.07.2016 (*nr. Vendimi 2960*).

⁷ Neni 64, **Shpallja dhe depozitimi i vendimit, pika 3** : Brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore.

Në tabelën 15 jepet një renditje e 30 çështjeve të vendimuara në vitin 2015 që reflektojnë edhe vonesat më të mëdha nga të gjitha vendimet e analizuara në kuadër të këtij monitorimi.

Tabela 15

Nr.	Nr. Akti	NR Vendimi	Date Vendimi	Date Dorezimi	Kohëzgjatja në dorëzim
1	485	2960	15.09.2015	20.07.2016	309
2	486	2961	15.09.2015	11.04.2016	209
3	148	3882	10.03.2015	18.09.2015	192
4	513	3174	29.09.2015	04.04.2016	188
5	527	3319	06.10.2015	11.04.2016	188
6	541	3399	13.10.2015	11.04.2016	181
7	34	2590	22.01.2015	20.07.2015	179
8	266	3985	05.05.2015	26.10.2015	174
9	572	3672	03.11.2015	14.04.2016	163
10	594	3779	05.11.2015	16.04.2015	163
11	67	3586	10.02.2015	20.07.2015	160
12	96	2832	12.02.2015	20.07.2015	158
13	482	2603	15.09.2015	17.02.2016	155
14	483	2962	15.09.2015	17.02.2016	155
15	60	2228	05.02.2015	07.07.2015	152
16	226	1317	19.04.2015	18.09.2015	152
17	248	3238	28.02.2015	29.07.2015	151
18	249	3360	28.02.2015	23.07.2015	145
19	244	1322	28.02.2015	22.07.2015	144
20	1	3364	13.01.2015	03.06.2015	141
21	633	4643	24.11.2015	13.04.2015	141
22	154	9379	12.03.2015	28.07.2015	135
23	549	3499	20.10.2015	03.03.2016	135
24	21	3094	20.01.2015	03.06.2015	134
25	22	3397	20.01.2015	03.06.2015	134
26	25	2598	20.01.2015	03.06.2015	134
27	2	2612	13.01.2015	25.05.2015	132
28	677	4645	09.12.2015	11.04.2016	124
29	309	4186	19.05.2015	18.09.2015	122
30	550	4647	20.10.2015	17.02.2016	120


ANALIZA KRAHASUESE KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË **2015 - 2019**

ANALIZA KRAHASUESE, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë

Shqyrtimi Gjyqësor, 2015-2019


Analiza e të dhënave sugjeron se kohëzgjatja për shqyrtimin e një rekursi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë në 2019-2018 ka qenë respektivisht 85-150 ditë më shumë krahasuar me vitin 2015, i cili përfaqëson edhe *baseline* në këtë studim 5-vjeçar të INFOCIP. Ndryshe nga sa besohet, ngarkesa gjyqësore nuk ndikon në kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor të rekurseve administrative në Gjykatën e Lartë. Koncretisht, për 897 rekurse që morën vendim nga Kolegji Administrativ në 2017, kohëzgjatja mesatare në shqyrtim rezultoi 903 ditë, ndërkohë që 145 rekurse që morën vendim në 2018 (pra 6 herë më pak se 2017-a), patën një kohëzgjatje mesatare deri në marrjen e vendimit prej 1116 ditësh.



VITI	2019 (1/2)	2018	2017	2016	2015
Numër	12 rekurse	145 rekurse	897 rekurse	604 rekurse	710 rekurse

Arsyetimi / Dorëzimi i vendimeve, krahasueshmëria 2015-2019

Nga të dhënat rezulton se ka një përmirësim të treguesve në vitin 2019 dhe 2018 sa i takon kohëzgjatjes së arsyetimit/dorëzimit të dosjes gjyqësore nga Kolegji Administrativ i GJL. Mesatarja e 2018-es është vetëm 2 ditë më shumë se sa afati që cakton neni 63, paragrafi 3 i ligjit Nr. 49/2012. Viti 2019 e përmirëson më tej këtë tregues, ku për herë të parë në historinë e Kolegjit Administrativ të GJL, mesatarja është brenda afatit ligjor 10-ditor. Sigurisht, në interpretimin e treguesve të vitit 2019 mund të mbahet parasysh se janë vetëm 12 vendime të marra në seancë nga Kolegji Administrativ. Sa për krahasim, në vitin 2017, në të cilin verifikohen edhe vonesat më të mëdha nga ky studim, i njëjti kolegji mori vendim në seancë për 897 rekurse.




VITI	2019 (1/2)	2018	2017	2016	2015
Numër	12 rekurse	145 rekurse	897 rekurse	604 rekurse	710 rekurse

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka përballur ngarkesën më të madhe të totalit të rekurseve të depozituar (pranuara) në këtë gjykatë. Nga vlerësimi tematik i ndërmarrë nga INFOÇIP rezulton se në 5 vitet e fundit të marra së bashku (**1 janar 2015-30 prill 2019**), Kolegji Administrativ i GJL dha në seancë vendime për **2368 rekurse**. Për të njëjtën periudhë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë dha **1042** vendime në seancë gjyqësore, kurse Kolegji Penal dha **644 vendime** në seancë (që nga viti 2015 e deri në momentin që pushuan se funksionuari për shkak të procesit të vetingut në vitin 2018).

Nga të dhënat e sipër-përmendura, rezulton se Kolegji Administrativ ka dhënë i vetëm më shumë vendime sesa dy kolegjet e tjera të marra së bashku në 5 vitet që analizon studimi. Ky krahasim flet pozitivisht në drejtim të ngarkesës që ka përballuar trupa e gjyqtarëve të këtij kolegji. *Grafiku më poshtë ofron një paraqitje vizuale të rekurseve të shqyrtuara dhe të konkluduara në vendim në seancë nga secili kolegji i GJL për periudhën 5 vjeçare që analizon ky studim.*



Nga analiza e ndërmarrë, rezulton se Kolegji Administrativ ka dhënë mesatarisht **rreth 50** vendime përfundimtare çdo muaj (në përlogaritjen e kësaj mesatareje, nuk përfshihet muaji Gusht, i cili është pushim zyrtar për gjykatat.)

Mesatarja vendimarrëse (në seancë) për Kolegjin Civil për të njëjtën periudhë rezulton 23 rekurse/ muaj, kurse për Kolegjin Penal rezulton të jetë 15 rekurse/muaj.

Vlen të theksohet se, në vitin 2019 Kolegji Administrativ i GJL mori vendim në seancë vetëm për 12 rekurse. Vendimi i fundit mban datën dt. 30/04/2019. Pas këtij momenti, Kolegji Administrativ dhe e gjithë Gjykata e Lartë kaluan në situatë kolapsi për shkak të procesit të *vetingut* i cili e la pa trupë gjyqësore dhe në pamundësi të plotë për të konfiguruar panel (kolegj) gjykimi.

Teksa grafiku më sipër flet pozitivisht për ngarkesën që ka përballur Kolegji Administrativ në raport me dy kolegjet e tjera të GJL, ai flet negativisht lidhur me situatën e pranimit të rekurseve. Kolegjet e Gjykatës së Lartë marrin vendim në dhomë këshillimi lidhur me pranimin e rekursit për shqyrtim gjyqësor. Një Gjykatë e Lartë, duke qenë në parim *gjykatë ligji*, duhet të jetë konservatore në përzgjedhjen/pranimin e rekurseve që merr nën shqyrtim. Sipas të dhënave të bëra publike nga vetë Gjykata e Lartë, ajo ka akumuluar një stok (backlog) prej 30 mijë dosjesh rekursi që presin të shqyrtohen.

Shifrat e analizuara nga INFOÇIP, por edhe ato të konfirmuara nga vetë Gjykata e Lartë në lidhje me *backlog*-un, sugjerojnë qartësisht ajo ka pranuar rekurse në sasi të pa-limituar dhe praktikisht e ka “mbytur” eficiencën e saj me “duart e veta”. Konsiderohet paradoksal fakti që vetë Gjykata e Lartë është ankuar sistematikisht lidhur me ngarkesën që ajo përball, por nga ana tjetër po kjo gjykatë ka pranuar masivisht rekurse për gjykim në shkallë të tretë.

Nga një vlerësim paraprak, në Kolegjin Administrativ janë pranuar me shumicë rekurse të palës së paditur (institucione publike), edhe pse këto të fundit kanë humbur në shkallë të parë dhe në apel. Për më tepër, një pjesë e resurseve apo energjisë së Gjykatës së Lartë është konsumuar në nxjerrjen e vendimeve për mos-ekzekutim të vendimeve të Apelit, pas pranimit të rekursit. Në kuadër të këtij studimi, kjo konsiderohet një praktikë negative, me pasoje direkte në uljen drastike të efikasitetit të Gjykatës së Lartë, e cila ka funksionuar si gjykatë fakti.


Nga vlerësimi sistematik i të dhënave gjyqësore, nga një total prej 2368 rekursesh të vendimuara nga ky kolegj në 5 vitet e fundit, vetëm 1% e tyre janë shqyrtuar brenda afatit ligjor 90 ditë që parashikon neni 60, pika 2 e ligjit nr. 49/2012,

të ndryshuar, sipas të cilit, “Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit dhe akteve bashkëlidhur prej gjykatës ku është depozituar rekursi”

Sa i takon afatit ligjor të dorëzimit të vendimeve, rezulton se vetëm 19.5 % janë dorëzuar konform dispozitës ligjore në fuqi. Ligji nr. 49/2012 lidhur me gjykimin në shkallë të tretë të mosmarrveshjeve administrative, përcakton se “brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore” (neni 64, paragrafi 3). Në kuadër të metodologjisë së përdorur nga INFOCIP, vlerat e treguesve të mësipërm konsiderohen “**nivël shumë të ulët të zbatimit të ligjit**” nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.


Analiza e krahasuar për kohezgjatjen gjyqësore, 2015-2019

Bazuar në treguesit e analizuar nga INFOCIP për periudhën 1 janar 2015-30 prill 2019, kohë në të cilën Gjykata e Lartë pushoi së funksionuari, rezulton se Kolegjit Administrative i janë dashur mesatarisht **867 ditë** për të dhënë vendim për rekursin e marra në shqyrtim gjyqësor prej tij (nga momenti i regjistrimit të rekursit deri në marrjen e vendimit në seancë). Për të njëjtin tregues, mesatarja e Kolegjit Civil rezulton **812 ditë**, kurse ajo e Kolegjit Penal rezulton **459 ditë**.




Arsyetimi / dorëzimi i vendimit përfundimtar

Rezulton se Kolegjit Administrativ i janë nevojitur mesatarisht **41.7 dite** për të kompletuar me arsyetimi e plotë ligjor një vendim të marrë prej trupës së tij në seancë gjyqësore. Për të njëjtin tregues, mesatarja e Kolegjit Civil rezulton të jetë **35.8 ditë**, kurse ajo e Kolegjit Penal rezulton **65 ditë** (5 vite në total).



Rezulton se Kolegji Administrativ ka treguesit më të mirë krahasuar më dy kolegjet e tjera sa i takon raportit: *ngarkesë gjyqësore / kohë shqyrtimi*. Ky është një tregues specifik që vlerëson rendimentin ose më mirë eficiencën e një kolegjii gjyqësor. Sa më i lartë koeficienti, aq më në eficiencë ka punuar një kolegj. Grafiku i mëposhtëm vizualizon këtë koeficient për të treja kolegjet, ku më të lartin e ka Kolegji Administrativ.



Procesi i vettingut ndikoi negativisht në efikasitetin gjyqësor të Gjykatës së Lartë në tërësi dhe Kolegjit Administrativ në veçanti. Krahasimisht, në vitin 2015, pra përpara Reformës në Drejtësi, ky kolegji arrinte të shqyrtonte dhe të merrte vendim për 710 rekorse. Ndërkohë, në vitin 2019, u vendimuan vetëm 12 rekorse administrative, “0” rekorse civile dhe “0” rekorse penale.

Nga ana tjetër, procesi i vettingut ekspozoi para publikut probleme serioze të integritetit të trupës gjyqësore të kësaj gjykate. Rasti më flagrant ishte ai i gjyqtarit Admir Thanza, i cili i kishte fshehur autoriteve shqiptare faktin se një gjykata italiane e kishte dënuar në vitin 1999 me vendim të formës së prerë (me 40 ditë burg dhe 100 mijë lireta gjobë). Dënimi penal në Itali i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, Admir Thanza u zbulua nga përfaqësuesit e ONM-së. Prokuroria e Përgjithshme nisi një hetim penal ndaj gjyqtarit Admir Thanza pas pezullimit/shkarkimit të tij. Gjykata e Tiranës e shpalli fajtor ish-gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, A. Thanza dhe e dënoi me 9 muaj burg, të konvertuar më pas në 18 muaj shërbim prove. Vendimi u dha në 31 mars 2018 ndërkohë që prokuroria kishte kërkuar dënimin e tij me 1.6 vite burg.

Prania e personave të tillë në trupën gjyqësore të Gjykatës së Lartë përbën një skandal. Rrethana të tilla kanë legjitimuar plotësisht vetimin e ashpër të gjithë trupës gjyqësore të GJL, që përfundoi në Korrik 2019 me largimit e vetë kryetarit të Gjykatës së Lartë, Z. Xhezair Zaganjori.

INFOCIP gjithsesi konsideron se mos-plotësimi i vendeve të mbetura vakant në Gjykatën e Lartë, tashmë të boshatisur, është një e metë e procesit. Ligjvënësit shqiptarë që miratuan Reformën në Drejtësi duhet të kishin parashikuar “planin e kontigjencës” për një situatë të tillë të paprecedentë. Pamundësia e organeve të reja gjyqësore, por edhe e institucioneve të larta vendimarrëse për të menaxhuar krizën e thellë që ekspozoi procesi i vettingut në Gjykatën e Lartë është një tregues që nuk flet në favor të një planifikimi të kujdesshëm.

Nëse deri para nisjes së vettingut, një pale ndërgjyqëse që kishte depozituar rekurs në Gjykatën e Lartë i duhet të priste mesatarisht 2.5 vjet për të marrë një vendim nga Kolegji Administrativ, në situatën aktuale të krijuar, zvarritja mund të jetë pa afat (pa tavan).

INFOÇIP rekomandon plotësimin e vendeve vakant në Gjykatën e Lartë pa vonesa të mëtejshme. Formula aktuale ligjore rezulton të jetë e kompromentuar për shkak të mosmarrveshjeve dhe/ose mosveprimit mes institucioneve përgjegjëse për caktimin e trupës gjyqësore në Gjykatën e Lartë.

Nwse situata e krijuar nuk zgjidhet vitit 2019, INFOÇIP rekomandon marrjen e masave të jashtëzakonshme për të vënë në punë Gjykatën e Lartë në të gjithë komponentët dhe funksionet e saj shumë të rëndësishme. Vlerësohet se në Kolegjin Administrativ, rreth 50-60 të *backlog*-ut aktual e përbëjnë konfliktet gjyqësore të pensioneve, të heqjes nga puna dhe të sigurimeve shoqërore. Shpejtësia në gjykimin e këtyre lloj rekurseve është e domosdoshme; shtyrja e tyre pambarim në kohë ekspozon në vështirësi ekonomike qindra qytetare shqiptarë që, për më tepër, janë në moshë të thyer.

Është i pakundërshtueshëm fakti se procesi i vetingut që zbraz Gjykatën e Lartë nuk eci paralel me procesin e plotësimit të vakancave në këtë gjykatë. Po ashtu, procesi i vetingut për trupën e Gjykatës së Lartë nuk eci paralel me procesin e vetingut për anëtarët kandidatë për plotësimin e vakancave. Ligjvënësi shqiptar duhet të kishte parashikuar më mirë harmonizimin e shpejtësive të këtyre proceseve paralele. Në vlerësimin e INFOÇIP ai gjithashtu mban përgjegjësi për situatën e krijuar në Gjykatën e Lartë, tashmë lënë plotësisht jashtë funksioni.

INFOÇIP konsideron se largimi i gjithë trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë brenda harkut kohor të 15-muajve ka dëmtuar seriozisht besueshmërinë e institucionit. Një konsideratë e tillë nuk përjashton treguesit negativë të vetë trupës gjyqësore që në mënyrë sistematike rrënoi prestigjin e Gjykatës së Lartë të RSH me zvarritjet ekstreme në gjykim, me pranimin pa kriter të rekurseve dhe me numrin relativisht të lartë të kthimeve për rigjykim të çështjeve gjyqësore. Infiltrimi në Gjykatën e Lartë i gjyqtarëve me precedentë penalë, si *Admir Thanza*, ishte goditje fatale për besueshmërinë e kësaj gjykate.

Sa i takon procesit të vetingut, INFOÇIP konsideron se ai duhet të kishte qënë më i përmbytur në dinamikën e vet kohore për të prodhuar një zgjidhje më realiste krahasimisht me zgjidhjen drastike që prodhoi duke shkarkuar të gjithë anëtarët e Gjykatës së Lartë (me përjashtim të gjyqtarit Ardian Dvorani).

INFOÇIP ri-thekson se boshatisja e Gjykatës së Lartë nga trupa gjyqësore dhe mos-plotësimi i vakancave për një kohë relativisht të gjatë, konsiderohet një situatë e jashtëzakonshme që dikton zgjidhje të jashtëzakonshme.

Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, që janë ende me vendim pezullimi nga KPK, paguhen nga taksapaguesit shqiptarë me 75% të pagës së tyre deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë në KPA (*neni 61/1, ligji Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”*). Kjo sasi e konsiderueshme parash që shteti shqiptar paguan aktualisht për gjyqtarët dhe prokurorët e pezulluar mund t’i shërbente më mirë qëllimit të një drejtësie pa vonesa nëse këta gjyqtarë ofrojnë kontributin e tyre në gjykatat e shkallëve më të ulëta. Për këtë më parë do të duhej të ndryshohej *neni 62, pika 2 e ligjit Nr. 84/2016*, që përcakton se “*subjekti i rivlerësimit nuk ka të drejtë të shqyrtojë dhe të gjykojë çështje*”.

INFOÇIP rekomandon miratimin e ndryshimeve ligjore që do të mundësonin gjyqtarë të vetuar të gjykatave të shkallëve më të ulëta të mund të ushtronin përkohësisht funksione të limituara gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, me mandat jo më të gjatë se 6 muaj, pa të drejtë ripërsëritje. Kjo praktikë padyshim që nuk është optimale, por do të ndihmonte gjithsesi që maja e piramidës gjyqësore të ishte funksionale deri në plotësimin me anëtarë me mandate të përherëshëm. Praktika e caktimit të gjyqtarëve nga një gjykatë në një tjetër është e njohur në nivel horizontal (midis gjykatave të njëjtës shkallë). Gjetja e një formule ligjore për adoptim e kësaj praktike edhe në nivel vertikal mund të konsiderohej një zgjidhje. Në një rast të tillë, gjyqtarët e përkohshëm nuk mund të marrin për shqyrtim në kolegje të bashkuara çështje për unifikimin/ndryshimin e praktikës gjyqësore, pasi kjo është një rezervë ekskluzive e një gjykate ligji.

Nisur nga rrethana faktike se shumica e dërmuese e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë u larguan nga detyra për arsye të mos-justifikimit të të ardhurave (pasurisë), INFOÇIP konsideron se ILDKPI, institucioni përgjegjës për vlerësimin sistematik të këtij komponenti që prej vitit 2017, ka përgjegjësi për mos-veprim dhe mos-reagim në kohë.

METODOLOGJIA, LEGJITIMITETI & EVIDENCAT E STUDIMIT

METODOLOGJIA E VLERESIMEVE TEMATIKE

Metodologjia e hartuar nga INFOÇIP konsiston në mbledhjen sistematike të të dhënave gjyqësore nga burime zyrtare që administrohen nga vetë gjykata. Procesi i mbledhjes së të dhënave diferencon në përzgjedhje datat e regjistrimit të çështjes gjyqësore dhe datat e dorëzimit në sekretarinë gjyqësore të vendimeve përfundimtare (dosjes gjyqësore pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor). Burim parësor konsiderohen regjistrat e gjykatave (*hard copy*).

Të dhënat procesohen më pas nga INFOÇIP në databaza të fuqishme të ndërtuara posaçërisht për qëllim të këtij vlerësimi. Sistemet e procesimit të dhënave janë të pajisuara paraprakisht me funksione filtrimi që mundësojnë vlerësimin e kohëzgjatjes apo vonesave eventuale. Kontrastimi i kohëzgjatjes me afatet procedurale të shprehura në ligj bëhet automatikisht nga sistemi.

Metoda e vlerësimeve tematike gjyqësore që ka konceptuar dhe përdor prej 6 vjetësh tashmë INFOÇIP mbledh dhe analizon të gjitha vendimet një për një, siç janë të regjistruara në varg indeksues të pandërprerë në numratorët gjyqësorë. Metoda e INFOÇIP nuk proceson një numër të reduktuar çështjes (30-40) të zgjedhura me kampionim, për të dalë në përfundime të përgjithshme, por të gjitha vendimet gjyqësore të dhënë në një vit kalendarik (ose disa vite) nga gjykata që monitorohet.

Për vitet 2015, 2016, 2017, 2018 si dhe për gjysmën e parë të vitit 2019 janë analizuar një për një të gjitha vendimet e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë të marra në seancë gjyqësore. Vendimet për pranim / mospranim rekursi (të marra në dhomë këshillimi) nuk janë përfshirë në vlerësim. Këto vendime janë disponuar gjithsesi nga INFOÇIP dhe janë të organizuara në një databazë të veçantë për vlerësimin e ngarkesës së trupës gjyqësore.

Për të realizuar vlerësimin tematik që përmban ky botim, është bërë identifikimi i saktë i dispozitave në kode/ligje që përcaktojnë afatet e shqyrtimit gjyqësor si ato që për arsyetimit/ dorëzimit të vendimeve gjyqësore. Legjitimiteti i matjeve dhe vlerësimeve në kuadër të këtij monitorimi buron direct nga ligji material/procedural, në rastin konkret nga ligji Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Treguesi SHDA (*Shqyrtimi i Dosjes Administrative*) është një indikator i posaçëm i konceptuar nga ekspertët e INFOÇIP për këtë lloj vlerësimi tematik. Ai pasqyrohet në pikë përqindje. SHDA përllogaritet si funksion i diferencës midis së treguesve të vitit aktual dhe vitit paraardhës për vlerat analoge. Në këtë rast ai indekssohet si “SHDA vertikale”, për ta dalluar atë nga “SHDA horizontale”, i cili aplikohet për të indikuar diferencat kur objekt krahasimi janë gjykata të ndryshme, të një niveli (shkalle) brenda të njëjtë vit.

Treguesi DAV (*Dorëzimi në Afat i Vendimeve*) është gjithashtu një indikator i posaçëm i konceptuar nga INFOÇIP që përdoret në këtë vlerësim tematik. DAV pasqyrohet në pikë përqindje. Ai është rezultat i diferencës midis vitit aktual dhe vitit paraardhës për vlerat që kanë të bëjnë me dorëzimin brenda afatit ligjor të vendimit të arsyetuar në Sekretari.

DAV përdoret për të matur progresin vit pas viti, në kushtet kur krijohet një bazë fillestare me të dhëna për krahasueshim (*comparative baseline*). Në këtë rast ai indekssohet si “DAV vertikale”, për ta dalluar atë nga “DAV horizontale”, i cili aplikohet për të indikuar diferencat kur objekt krahasimi janë gjykata të ndryshe brenda të njëjtë vit, (siç në rastin e krahasimit të gjykatave administrative të shkallës së parë).

DAV është një indikator absolut. Ai nuk relativizon apo ponderon rezultatin bazuar në ngarkesën e gjyqtarëve, vështirësinë e çështjeve, apo shkaqe të tjera subjektive. Pjesë e rëndësishme e këtij studimi është edhe krahasimi i treguesve mes gjykatave të të njëjtë lloj. Ky lloj vlerësimi synon të ofrojë një pamje më të plotë për kuptuar më mirë dinamikat që favorizojnë (ose jo) shqyrtimin e çështjeve gjyqësore (themeli) brenda një kohë të arsyeshme si dhe dorëzimin në afat të vendimeve. Në një rast të tillë, treguesit SHDA dhe DAV aplikohen për një vlerësim të tipit horizontal dhe jo vertikale, sikurse është ai që indikon progresin nga viti në viti në të njëjtën gjykatë.

Për të aplikuar analizën SHDA/DAV horizontale, nuk ka nevojë të fiksohet një baseline i diferencuar kohor; mjafton që të dhënat të jenë të mbledhura brenda të njëjtës periudhë kohore për të siguruar bazë krahasimore të njëjtë. Në thelb, analiza synon të rendisë bazuar në vlerat e treguesve gjykata e të njëjtë lloj të marra nën shqyrtin. Po ashtu kjo analizë ofron mundësi për të bërë përgjithësime në bllok. Ndërkohë, për të aplikuar analizën SHDA/DAV vertikale, është e nevojshme të fiksohet një *baseline* i bashkë-matshëm kohor.

LEGJITIMITETI DHE BAZA LIGJORE

Ky vlerësim tematik mat dhe vlerëson respektimin e afateve procedurale të shqyrtimit gjyqësor në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Ky kolegji i posaçëm iu shtua dy kolegjeve të tjera të Gjykatës së Lartë (Civil dhe Penal) në vitin 2012, pas miratimit nga Kuvendi Ligjit nr. 49/2012 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative (ndryshuar me ligjin nr. 100/2014)*. Është pikërisht ky ligj i cili normon në mënyrë koncize në Kreun X të tij afatet e shqyrtimit të rekursit për shkallën e tretë të gjykimit administrativ. Monitorimi i realizuar nga INFOCIP fillimisht mat dhe vlerëson kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor dhe atë të dorëzimit të vendimeve të marra në seancë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Përfundimet e vlerësimit sa i takon kohëzgjatjes së çdo rekursi më pas kontrastohen me afatet që përshkuan Kreu X i Ligjit 49/2012. Afati ligjor për shqyrtimin dhe ai për dorëzimin e vendimit të arsyetuar janë theksuar (më shkrim bold), në pasazhin ligjor më poshtë:

KREU X

REKURSI NË GJYKATËN E LARTË

Neni 60

Dërgimi i rekursit në Gjykatën e Lartë

1. Gjykata administrative e shkallës së parë dërgon rekursin, së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, vendimin e gjyqtarit për pranimin e rekursit, aktet e komunikimit të rekursit, kundërrekursin, si dhe dosjen e gjykimit në Gjykatën e Lartë, brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve.
2. ***Gjykata e Lartë shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit dhe akteve bashkëlidhur prej gjykatës ku është depozituar rekursi.***

Neni 61

Gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë

(ndryshuar me ligjin nr. 100/2014)

1. Shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.
2. Gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton, me shpallje, ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara.
3. Gjyqtari relator përgatit relacionin, duke pasqyruar në të, edhe përmbajtjen e vendimit të ankimuar, pretendimet dhe shkaqet e ngritura në rekurs, prapësimet e paraqitura në kundërrekurs, shqyrtimin e fakteve që kanë rëndësi për marrjen e vendimit dhe propozimin e tij për zgjidhjen ligjore të çështjes.
4. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor.

Neni 62

Gjykimi në seancë gjyqësore

1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se:
 - a) rekursi është paraqitur ndaj një vendimi të apelit administrativ, lidhur me gjykimin e aktit nënligjor normativ;
 - b) konstaton se vendimi i apelit administrativ është i ndryshëm nga praktika e kolegjit administrativ ose edhe e kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë;
 - c) vlerësohet e nevojshme nga kolegji administrativ thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes.
2. Vendimi i mësipërm, data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore, të paktën 15 ditë para datës së zhvillimit të seancës gjyqësore

Neni 64

Shpallja dhe depozitimi i vendimit

1. Vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, shpallet detyrimisht i arsyetuar.
2. Në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 10 ditë.
3. ***Brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore***

EVIDENCAT GJYQËSORE DHE BAZA E TË DHËNAVE

Databaza për kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor:

Viti 2019- <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-larte-kolegji-administrativ-viti-2019-kohezgjatja-e-shqyrtimit-gjyqesor/>

Viti 2018- <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-larte-kolegji-administrativ-viti-2018-kohezgjatja-e-shqyrtimit-gjyqesor/>

Viti 2017- <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-larte-shqyrtimi-gjyqesor-viti-2017-kolegji-administrativ/>

Viti 2016- <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-larte-shqyrtimi-gjyqesor-viti-2016-kolegji-administrativ/>

Viti 2015- <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-larte-shqyrtimi-gjyqesor-viti-2015-kolegji-administrativ/>

Databaza për kohën e arsyetimit / dorëzimit të vendimit:

Viti 2019- <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-larte-kolegji-administrativ-viti-2019-kohezgjatja-e-dorezimit-te-vendimit/>

Viti 2018- <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-larte-kolegji-administrativ-viti-2018-kohezgjatja-e-dorezimit-gjyqesor/>

Viti 2017- <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-larte-dorezimi-i-vendimeve-viti-2017-kolegji-administrativ/>

Viti 2016- <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-larte-dorezimi-i-vendimeve-viti-2016-kolegji-administrativ/>

Viti 2015- <https://www.gjykataehapur.al/gjykata-e-larte-dorezimi-i-vendimeve-viti-2015-kolegji-administrativ/>

MBI PLATFORMËN ONLINE “GJYKATA E HAPUR”

Gjykata e hapur për publikun dhe për median është një vizion që ka orientuar punën e INFOCIP që prej vitit 2012. Platforma www.gjykataehapur.al është sintesa e kësaj veprimtarie 7-vjeçare për të krijuar akses sistematik të publikut dhe medias në të dhënat gjyqësore të RSH.

Platforma www.gjykataehapur.al aktualisht mbulon 100% me vlerësim sistemin e gjykatave administrative në RSH. Po ashtu, Platforma analizon sistematikisht prej vitit 2015 praktikën e Gjykatës së Lartë, duke shënuar një këtë mënyrë një moment kthese në vlerësimin sistematik të majës së piramidës gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.

Kjo Platformë, përveç aksesit, mundëson vlerësimin objektiv të kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore. Përmes teknologjisë dixhitale, Platforma kontraston dhe interpreton marrdhënien midis afateve ligjore dhe kohëzgjatjes faktike të çështjeve gjyqësore. Objekt parësor vlerësimi është koha e shqyrtimit gjyqësor dhe koha e arsyetim/dorëzimit të vendimeve. Të dy këta komponentë janë treguesit bazë për efektivitetin dhe eficiencën e gjykatave. Ata janë gjithashtu kusht dhe kriter për të vlerësuar gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. Përmes www.gjykataehapur.al ky lloj vlerësimi është tashmë 100% i automatizuar.

Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar! Një drejtësi e dhënë shpejt dhe me cilësi është një shërbim publik me vlera të pakrahasueshme për ndërtimin e besimeve tek ligji, shteti dhe institucionet e tij. Platforma www.gjykataehapur.al i shërben këtij qëllimi madhor.

Efektiviteti i gjykatave dhe efienca mund të vlerësohen vetëm përmes të dhënave. Gjykatat shqiptare e regjistrojnë në letër aktivitetin e tyre, duke e bërë të vështirë analizën tematike të vonesave në gjykim por edhe në vlerësimin e performacës së gjyqtarëve. Bërja e këtyre lloj vlerësimesh konsumon kohë dhe resurse njerëzore. Platforma www.gjykataehapur.al i jep zgjidhje këtij problem përmes një procesi teknologjik që mundëson procesimin në format elektronik të të dhënave gjyqësore.

Platforma www.gjykataehapur.al mundëson vlerësimet tematike të vonesave gjyqësore përmes filtrave dhe algoritmeve të dizenuara për këtë qëllim nga INFOCIP. Vlerësimi i vonesave është i bazuar 100% në të dhëna të faktueshme dhe rrjedhimisht objektiv. Platforma www.gjykataehapur.al shënon një moment kulmor të përdorimit të teknologjive të reja të informacionit për vlerësime të pavarura në sistemin e gjykatave të RSH.

Platforma www.gjykataehapur.al është një sistem i hapur për publikun, gjykatat, median dhe gjithë partnerët institucionalë të interesuar. Aktualisht Platforma administron dhe përpunon mbi 9.5 milion të dhëna gjyqësore, të cilat janë në shtim të vazhdueshëm

Platforma www.gjykataehapur.al është pasuruar me të dhëna gjyqësore nga gjykatat e sistemit të zakonshëm, duke përfshirë fillimisht gjykatat e karrierrës në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë dhe duke u zgjeruar gradualisht në të gjitha gjykatat e rretheve gjyqësore të RSH.

Funksione të reja janë duke u projektuar dhe shtuar nga stafet e INFOCIP, të cilat mundësojnë vlerësime tematike speciale. Konkretisht ka përfunduar dhe është operacional sistemi i ri i vlerësimit tematik për çështjet gjyqësore administrative me objekt “marrdhëniet e punës”, ku për herë të parë është testuar me sukses edhe afishim i skedave gjyqësore si dhe përlllogaritja e dëmit ekonomik.

Platforma www.gjykataehapur.al është ndërtuar nga INFOCIP, mbështetur fillimisht nga Open Society Foundation for Albania. Ajo është populluar me të dhëna të vazhdueshme falë mbështetjes së National Endowment for Democracy, NED, Washington D.C.

Ambasada e SHBA në Tiranë përmes Programit të Granteve të Vogla ka mbështetur INFOCIP për të realizuar popullimin e Platformës me të dhëna të reja nga sistemi i gjykatave të zakonshme. Së fundmi, INFOCIP ka siguruar mbështetjen e Qeverisë Holandeze për zgjerimin e mbulimit me monitorim të gjykatave të apelit dhe gjykatave të rretheve.

